

## MENDIM PAKICE

Unë, komisionere Firdes Shuli, anëtare e trupit gjykues, që ka kryer procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Marjeta Zaimi, kam votuar kundër vendimit për konfirmimin në detyrë të këtij subjekti, duke parashtruar arsyetimin tim, lidhur me disa nga problematikat e rezultuara për kriterin e pasurisë, të cilat i kam konsideruar të mjaftueshme për të argumentuar votën time kundër, si vijon:

1. Në lidhje me pasurinë depozitë në BKT krijuar në datën 25.10.2010, në vlerën 1,000,000 lekë dhe gjendje më 26.1.2017. Vlera: 8,014.53 euro. Pjesa takuese: 50%. Si burim krijimi të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar: (i) një pjesë e depozitave të tërhequra në vitet 2009 – 2010; dhe (ii) kursimet nga paga, të deklaruara në deklarin e pasurisë në vitin 2010.

Nga të dhënat bankare ka rezultuar se kjo depozitë është krijuar fillimisht në datën 26.10.2010 me depozitim *cash* të shumës 1,000,000 lekë nga bashkëshorti i subjektit, e cila në datën 6.8.2010 ka arritur vlerën 1,077,662.15 lekë. Si burim për krijimin e depozitës në shumën 1,000,000 lekë, subjekti në DPV-në për vitin 2010 ka deklaruar: “ *një pjesë e depozitës së tërhequr në vitin 2009 e të deklaruar në deklarin e vitit 2010* ”.

Nisur nga ky deklarin, subjekti është pyetur të japë sqarime në lidhje me datën e saktë të kryerjes së tërheqjes në vitin 2009, bankën ku është kryer veprimi i tërheqjes, shumën e tërhequr dhe pjesën e përdorur prej tij si burim për krijimin e depozitës në datën 26.10.2010, subjekti ka deklaruar midis të tjerash se kjo *depozitë është tërhequr më 4.11.2008<sup>1</sup>, nga ‘Tirana Bank’ prej bashkëshortit të saj B. Z. në vlerën 1.662.600 lekë*.

Në përfundim të hetimit administrativ Komisioni ka konstatuar : duket se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shumën prej 1,662,600 lekësh në deklaratën e pasurisë së vitit 2008 si depozitë e tërhequr në “Tirana Bank” në datën 31.10.2008 (që në fakt është më 4.11.2008), por nuk e ka deklaruar këtë shumë si kursime *cash* në vitin 2008.

Në prapësimet e tij dhe në seancën dëgjimore, subjekti ka pretenduar se: *në DPV-në e viti 2008, gjendja cash është deklaruar në faqen 4 të deklaratës e ndarë sipas burimit të krijimit dhe më konkretisht: shuma 1,500,000 lekë nga një pjesë e kontratës paraprake të shitjes; si dhe shuma 1,662,600 lekë nga tërheqja e depozitës në “Tirana Bank” në datën 31.10.2008. Gjendja cash në banesë në fund të vitit 2008, ka qenë e lartë, për shkak se ajo dhe familja e saj ishin në kërkim të blerjes së një apartamenti. Gjendja cash e deklaruar në DPV-në për vitin 2009 është në shumën 3,500,000 lekë. Gjatë këtij viti është kthyer shuma 1,000,000 lekë, por është shtuar tërheqja e depozitës 659,500 lekë dhe kursimet e vitit në shumën prej 950,000 lekësh.*

Në pikën 1. 7 të vendimit, shumica ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me deklarin e gjendjes cash për vitin 2008, duke marrë në konsideratë faktin se subjekti, pavarësisht se nuk ka deklaruar tërheqjen e depozitës si burim të kursimeve cash, ka deklaruar tërheqjen e saj në datën 30.10.2008, duke argumentuar se gjendja e lartë cash nevojitej nëse do të ofrohej mundësia për blerjen e apartamentit, blerja e të cilit ishte prioritet në momentin, ku sapo ishin transferuar nga qyteti i Fierit. Shuma prej 1,662,690 lekësh e tërhequr nga banka më 30.10.2008, pasqyrohet si e tillë dhe e paprekur deri më 31.12.2008, që është data e fundit e pasqyrimit të ndryshimeve, shtesa dhe pakësime të pasurisë që deklarohet për vitin përkatës, veprime këto të ndodhura në një periudhë të shkurtër kohore, dy mujore. Gjithashtu, nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk rezultoi që deri në fund të vitit të ketë krijuar ndonjë pasuri tjetër, ku të jetë përdorur shuma e depozitës së tërhequr.

---

<sup>1</sup> Referuar shkresës nr. \*\*\* prot., datë 27.1.2020, të “Tirana Bank”, shuma 1,662,600 lekë është tërhequr jo në datën 30.10.2008, por më 4.11.2008. Kjo diferencë në kohë është konsideruar e parëndësishme për shkak se nuk afekton në analizën financiare të subjektit dhe në përfundim të rezultateve të hetimit është shprehur si datë 31.10.2008, për të shmangur ndonjë konfuzion të mundshëm.

Edhe gjendja cash prej 3,500,000 lekësh e deklaruar në DIPP-në e vitit 2009 krijon bindjen se gjendja cash në vitin 2008 është në shumën 3,162,600 lekë. Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me situatën e gjendjes cash në datën 31.12.2008, të deklaruar në DIPP-në e vitit 2008.

Unë si anëtare në pakicë, nuk jam dakord me arsyetimin e shumicës, duke vlerësuar që subjekti nuk ka arritur të kundërshtojë barrën e provës lidhur me likuiditetin prej 1,662,600 lekësh të pretenduar si gjendje *cash*-i në vitin 2008, të cilin vetëm në deklaratimet gjatë procesit të rivlerësimit pohon ta ketë përdorur për krijimin e depozitës objekt shqyrtimi, për arsytet si vijojnë:

Së pari, sa i takon burimit të krijimit të depozitës objekt shqyrtimi, është konstatuar se :

a. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se si *burim për krijimin e depozitës në BKT, krijuar në datën 25.10.2010, në vlerën 1,000,000 lekë kanë qenë: (i) një pjesë e depozitave të tërhequra në vitet 2009 – 2010; dhe (ii) kursimet nga paga, të deklaruara në deklaratimin e pasurisë në vitin 2010*. Siç vërehet, subjekti nuk ka përmendur si burim tërheqjen e depozitës në vitin 2008, prej 1,662,600 lekësh, të pretenduar të mbajtur *cash* gjatë këtij viti.

b. Në DPV-në për vitin 2010, subjekti në mënyrë te paqartë ka deklaruar si burim: *një pjesë e depozitës së tërhequr në vitin 2009 e të deklaruar në deklaratimin e vitit 2010*, pa përmendur tërheqjen e depozitës në vitin 2008, prej 1,662,600 lekësh.

c. Në deklaratimet gjatë procesit të rivlerësimit, për herë të parë subjekti ka deklaruar si burim krijimi të depozitës objekt shqyrtimi, depozitën e tërhequr më 4.11.2008 (deklaruar nga subjekti më 30.10.2008) nga “Tirana Bank” prej bashkëshortit B. Z., në vlerën 1.662.690 lekë.

Pra, siç vërehet, ka paqartësi e mospërputhje deklarimesh në lidhje me burimin e krijimit të depozitës objekt shqyrtimi, të cilat vlerësoj se subjekti e kishte mundësinë dhe duhet t’i qartësonte gjatë plotësimit të deklaratës vetting.

Se dyti, sa i takon gjendjes *cash* në fund të vitit 2008, referuar DPV-së për vitin 2008, në rubrikën “Të ardhura dhe angazhimet në veprimtari publike ose private”, subjekti ka deklaruar: (i) të ardhura *cash* në shumën 1,500,000 lekë me burim një pjesë e kontratës paraprake të shitjes e përmendur në faqen 3<sup>2</sup> të deklaratës; (ii) depozitë e tërhequr nga “Tirana Bank”, në shumën 1,662,690 lekë, datë 31.10.2008<sup>3</sup>. Pra, gjendja *cash* e deklaruar nga subjekti ka qenë në shumën 1,500,000 lekë, me burim të mirëpërcaktuar.

Kur është pyetur nga ILDKPKI-ja, në lidhje me gjendjen cash të pasqyruar në procesverbalin e datës 18.4.2016, subjekti ka pretenduar se shumën prej 1,662,600 lekësh të tërhequr nga “Tiranë Bank”, në datën 31.10.2008, e ka pasur gjendje *cash* në banesë, duke deklaruar se: *“Për sa i përket gjendjes cash deklaroj se në vitin 2008 kam pasur gjendje në banesë shumën 3,100,000 lekë, pasi në datën 31.10.2008 unë kam tërhequr depozitën në ‘Tirana Bank’, në shumën prej 1,662,690 lekësh, të cilën e kam deklaruar si të ardhur në deklaratën e vitit 2008 duke mos ia shtuar gjendjes cash prej 1,500,000 lekësh”*.

Ndërsa gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti vijon të deklarojë se në fund të vitit 2008, ka pasur *cash* shumën 3,100,000 lekë dhe jo shumën 1,500,000 lekë, duke pretenduar se si burim i këtij cashi, ka shërbyer dhe shuma 1,662,600 lekësh tërhequr nga “Tiranë Bank”, në datën 31.10.2008.

<sup>2</sup> Shitje apartamenti me sip. 85.1 m<sup>2</sup>, lagjja “\*\*\*\*”, Fier, me kontratë paraprake nr. \*\*\*, në shumën 3,100,000 lekë.

<sup>3</sup> Kjo shumë është krijuar nga depozitimi i dy shumave 850,000 lekë dhe 800,000 lekë te “Tirana Bank”, përkatësisht në datat 3 dhe 4 korrik të vitit 2008. Si burim për depozitimet e mësipërme, ka shërbyer shuma e përfituar me kontratën paraprake të shitjes nr. \*\*\*, datë 3.7.2008, lidhur me shtetasin K. B..

Në fakt, nga verifikimi i DPV-së për vitin 2009, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 3.500.000 lekë me burim *një pjesë e të ardhurave të tërhequra nga depozitat bankare të deklaruara në vitin 2009 së bashku me të ardhurat e deklaruara po atë vit, si dhe depozitën e tërhequr dhe deklaruar në paragrafin më sipër*<sup>4</sup>.

E pyetur nga Komisioni, në lidhje me deklarimin e gjendjes *cash* në fund të vitit 2009, në shumën prej 3.500.000 lekësh, subjekti, ka deklaruar se: “... *depozitat e deklaruara në vitin 2009 dhe të përshkruara për atë vit, janë të ardhura për vitin 2008. Shënimi i vitit 2009 është pasaktësi (pakuja)*...*të ardhurat që kanë shërbyer për krijimin e shumës Cash në vitin 2009 në vlerën 3,500,000 lekë janë: (i) depozita e tërhequr më 4.11.2008, nga ‘Tirana Bank’ prej bashkëshortit tim B. Z. në vlerën 1,662,600 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind) lekë; (ii) pjesa e të ardhurave cash të mbetura nga shitja e banesës në vitin 2008, në shumën prej 500,000 (pesëqind mijë) lekësh (pas kthimit të vlerës të blerësi, si rrjedhojë e ndryshimit të çmimit të shitjes së apartamentit të ndodhur në Fier nga shitja paraprake), në këtë vlerë përfshihet edhe gjendja cash në fund të vitit 2008, në shumën 150,000 lekë*<sup>5</sup>; (iii) *depozita e tërhequr prej meje nga ‘Raiffeisen Bank’ në datën 30.1.2009, në vlerën 659,500 lekë; (iv) të ardhura cash të krijuara nga të ardhurat gjatë vitit 2009 (pagat dhe shpërblimet), në vlerën 650,000 lekë”.*

Siç vërehet, subjekti pranon pasaktësinë në deklaratën për vitin 2009 për shkak të pakujdesisë, duke detajuar se nga çfarë përbehet *cash*-i prej 3.500.000 lekësh, e duke pranuar se në shpjegimet e tij në lidhje burimin e të ardhurave *cash* të kësaj deklarate, nuk e kishte përfshirë gabimisht shumën 1,662,690 lekë, të mbartur si gjendje *cash* nga viti 2008.

Në analizë të të gjitha provave dhe fakteve të sipërpërmendura konstatohet se:

a. Në DPV-në për vitin 2008, subjekti e ka deklaruar tërheqjen nga “Tirana Bank” në shumën 1,662,690 lekë, datë 4.11.2008, por nuk e ka deklaruar këtë shumë si gjendje *cash* në fund të vitit 2008, sipas detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 4 të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar. Ndërkohë, gjendja *cash* e deklaruar, është shuma 1,500,000 lekë me shpjegimin e burimit : *një pjesë e kontratës paraprake të shitjes së përmendur në faqen 3 të deklaratës*. Pra, subjekti e ka pasur të gjithë mundësinë dhe detyrimin ligjor, që ashtu sikurse ka deklaruar gjendjen *cash* në shumën 1,500,000 lekë duke specifikuar dhe burimin, te deklaronte edhe gjendjen *cash* të pretenduar në shumën prej 1,662,000 lekësh, tërhequr nga Banka në datë 4.11.2008. Në këto kushte, deklarimi gjatë procesit të rivlerësimit, se në fund të vitit 2008 gjendja *cash* ka qenë më e lartë, mbetet në nivel deklarativ.

b. Në DPV-në e vitit 2009, nuk është përmendur si burim i gjendjes *cash*, depozita e tërhequr nga “Tirana Bank” në vitin 2008.

Gjithashtu, vlerësoj se arsyetimi i shumicës se nga hetimi nuk rezultoi që deri në fund të vitit të ketë krijuar ndonjë pasuri tjetër ku të jetë përdorur shuma e depozitës së tërhequr, si anëtare në pakicë nuk e vlerësoj bindës, pasi vetëm deklarimi i gjendjes *cash* do të përbënte provën për të vërtetuar faktin nëse subjekti e ka pasur këtë likuiditet dhe nuk e ka shpenzuar. Është pikërisht ky qëllimi i ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, i cili ka përcaktuar qartë detyrimin e subjekteve për të deklaruar çdo lloj pasurie, duke përfshirë dhe likuiditetet *cash* në fund të viteve përkatëse, si dhe shtesat dhe pakësimet e tyre.

Për të gjitha sa me sipër, shuma prej 1.662.000 lekësh tërhequr nga “Tirana Bank” në DPV-në për vitin 2008, në vlerësimin tim, nuk duhet të konsiderohet si burim i ligjshëm për krijimin e

<sup>4</sup> Depozite e tërhequr ne RF Bank, ne dates 26.01.2009 ne shumen 660,681 leke.

<sup>5</sup> Ky është një lapsus i subjektit, pasi shuma është 1,500,000 dhe jo 150,000 lekë.

gjendjes *cash* prej 3.500.000 lekësh të deklaruar në DPV-në për vitin 2009, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, fakt që afekton analizën financiare për këtë vit.

2. Në lidhje me pasurinë apartament me sip. 103 m<sup>2</sup>, në emër të bashkëshortit të subjektit, z. B. Z., përfituar me kontratë shitblerje me rezervë e pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\*, datë 22.4.2011, në Tiranë, në vlerën 87,750 euro me pjesë takuese 100% (kontratë kredie bankare, datë 2.6.2011, bashkëngjitur kësaj deklaratë), në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar midis të tjerash:

**2.1.** Duket se ka deklarime kontradiktore të palëve<sup>6</sup> në lidhje me kohën e kryerjes së pagesave për apartamentin<sup>7</sup>. Në prapësimet e tij, subjekti ka pretenduar se pasaktësitë në deklaratat noteriale apo deklarimet e kryera kanë ndodhur për shkaqe objektive apo për shkak se faktet janë deklaruar referuar kujtesës. Për shkak të kohës së gjatë të kaluar nuk ka qenë e mundur që deklarimet të ishin me saktësi të plotë.

Në gjykimin tim, në kundërshtim me çfarë argumenton shumica, subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse për mospërputhjet e konstatuara në lidhje me deklarimet për kohën e kryerjes së pagesave të apartamentit, pasi, pavarësisht mospërputhjeve, nga verifikimi i lëvizjeve bankare, rezulton se pagesat janë kryer në rrugë bankare me transferta dhe në këtë mënyrë ato janë lehtësisht të verifikueshme. Pra, mospërputhjet duket se vijnë për shkak të pamjaftueshmërisë së të ardhurave të ligjshme të burimeve të përdorura për blerjen e këtij apartamenti, siç kam trajtuar më poshtë dhe jo për shkaqe të cilat i pretendon subjekti.

**2.2.** Duket se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme në lidhje me pagesën e shumës prej 2,500,000 lekësh, në datën 8.6.2011 (me burim pakësimin e gjendjes *cash* në vitin 2010), pasi gjendja *cash* e deklaruar në DPV-në e vitit 2010, në shumën 950,000 lekë, është e pamjaftueshme. Tërheqjet bankare në shumat 433,000 lekë më 11.1.2010 dhe 1,794,700 lekë më 3.3.2010 të deklaruara nga subjekti në pyetësorë, si burim për gjendjen *cash* në vitin 2010, nuk janë deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2010. Në lidhje me këtë konstatim, subjektit i ka kaluar barra e provës.

Në prapësimet e tij subjekti ka pretenduar se në DPV-në e vitit 2010, vlera 950,000 lekë nuk është gjendje *cash*, por është shtesë e gjendjes *cash* të krijuar gjatë këtij viti, kështu që gjendja e *cash* në fund të vitit 2010, është në shumën 3,450,000 lekë. Sipas subjektit, kjo shumë e ka burimin te gjendja *cash* prej 3,500,000 lekësh deklaruar për vitin 2009, të cilës i është shtuar shuma prej 950,000 lekësh me kursime të vitit 2010, si dhe është pakësuar me 1,000,000 lekë nga hapja e depozitës në BKT, në vitin 2010.

Siç vërehet në arsyetimin e shumicës, këto pretendime janë marrë në konsideratë dhe shuma prej 2,500,000 lekësh është konsideruar me burim të ligjshëm nga kursimet *cash* të vitit 2010, vlerësim me të cilin unë nuk ndaj të njëjtin mendim, arsyetuar si vijon:

Nga të dhënat bankare janë verifikuar faktet: (i) në datën 13.5.2011, subjekti ka depozituar *cash* shumën prej 2,500,000 lekësh në BKT; (ii) në datën 8.6.2011, shuma prej 2,500,000 lekësh është paguar nga subjekti me transfertë bankare në llogarinë e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., si një këst për pagimin e çmimit të blerjes së pasurisë objekt shqyrtimi.

Në DPV-në e vitit 2010 subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në vlerën 950,000 lekë, me përshkrimin “*të ardhura cash me burim krijimi kursime nga paga dhe të ardhura të tjera të*

<sup>6</sup> Midis subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit nga njëra anë dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., nga ana tjetër.

<sup>7</sup> Në deklaratën e datës 2.6.2011, deklarohet se pagesa do të bëhet brenda datës 30.0.2011; në deklaratën e datës 29.6.2011 deklarohet që palët u likuiduan totalisht midis tyre; në deklaratën noteriale të datës 24.4.2020 deklarohet që pagesat janë bërë në muajt qershor dhe dhjetor të vitit 2011, në pyetësorin nr. 2, subjekti deklaroi që pagesat janë bërë në muajt qershor dhe tetor të vitit 2011.

*deklaruar*”. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe gjatë pyetjes në ILDKPKI në datën 18.04.2016, ku ka deklaruar gjendjen *cash* të vitit 2010, shumën 950.000 leke.

Gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti ka deklaruar se gjendja *cash* në vitin 2010 ka qenë 3,450,000 lekë dhe jo 950,000 lekë, pretendim të cilin shumica e ka pranuar. Unë, si anëtare në pakicë, nuk jam dakord me pretendimet e subjektit dhe me arsyetimin e shumicës, pasi:

a. Në të gjitha DPV-të e mëparshme përpara vitit 2011, i cili është viti i fundit që subjekti ka deklaruar në lidhje me gjendjen *cash*, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* dhe jo shtesa, megjithëse deklarata periodike e pasurisë kërkon deklarimin e shtesave dhe pakësimeve të pasurive gjatë një viti. Ky fakt evidentohet lehtë nga mënyra e njëtrajtshme e deklarimit në pikpamjen formale në të gjitha deklaramet periodike, ku subjekti ka shprehur shumë qartë gjëndjet *cash* duke shkruar në çdo rast fjalët *të ardhura cash* dhe, në vijim, burimin e krijimit. Këtë fakt, pra deklarimin e gjendjeve *cash* dhe jo shtesave të kësaj gjendjeje, subjekti e ka pranuar në DPV-të për të gjitha vitet, ashtu sikurse dhe shumica me të drejtë i ka konsideruar. Ndërsa, sa i takon deklarimit të shumës 950.000 lekë në DPV-në për vitin 2010, në mënyrë të pakuptueshme subjekti pretendon se kjo shumë nuk është gjendja e *cash*-it por është është shtesë e gjendjes *cash* mbi shumën 3,500,000 lekë deklaruar si gjendje *cash* për vitin 2009.

b. Gjatë pyetjes në ILDKPKI në datën 18.04.2016, subjekti ka deklaruar gjendjen *cash* të vitit 2010 shumën 950.000 leke.

c. Shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit numër 2, në lidhje me gjendjen *cash* të vitit 2010 janë kontradiktore, pasi sipas njërit version gjendja *cash* është 3,500,000 lekë gjendje *cash* në vitin 2009 + 950,000 kursime të vitit 2010 – 1,000, 000 lekë depozituar në BKT, ndërsa sipas një versioni tjetër, gjendja *cash* është 950,000 lekë kursimet nga pagat e vitit 2010 + 433,000 depozitë e tërhequr nga “Raiffeisen Bank” + 1,794,700 lekë depozitë e tërhequr nga “Tirana Bank”. Por, këto tërheqje nuk përputhen me deklaramet në DPV-në për vitin 2011, fakt të cilin subjekti e pranon, por, pretendon se ka dorëzuar dokumentin “shënimi shtesë” pranë ILDKPKI, ku ka korrigjuar këtë DPV, pretendim i cili mbetet në nivel deklarativ.

Në vlerësimin tim, në referim të të gjitha rrethanave të përshkruara më sipër, nuk ka arsye legjitime që shuma prej 950,000 lekësh të konsiderohet si shtesë e gjendjes *cash*, por duhet konsideruar si gjendje *cash* në fund të vitit 2010, ashtu sikurse subjekti e ka deklaruar në DPV për këtë vit dhe gjatë pyetjes në ILDKPKI në datën 18.04.2016. Për rrjedhojë, kjo është shuma që duhet të konsiderohet si burim i ligjshëm për pagesën e shumës 2,500,000 lekë, në datën 8.6.2011, për blerjen e pasurisë objekt shqyrtimi dhe konstatimi fillestar se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme për pagesën e shumës prej 2,500,000 lekësh, në datën 8.6.2011, mbetet i njëjtë me atë të dërguar me rezultatet e hetimit.

**2.3.** Duket se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme në lidhje me pagesën e shumës 23,000 euro (3,250,130 lekë) në datën 22.6.2011, pasi një nga burimet e krijimit të kësaj pagese që është gjendja *cash* e deklaruar në DPV-në e vitit 2010 (950,000 lekë) është përdorur për pagesën e datës 8.6.2011. Gjithashtu edhe dhënia e ndihmës financiare nga të afërmit, e cila nuk është deklaruar në DPV-në e vitit 2011 dhe në deklaratën *Vetting*, nuk është e provuar me dokumentacion ligjor dhe mbetet vetëm në kuadër deklarativ. Në lidhje me këto konstatime, subjektit i ka kaluar barra e provës.

Në prapësimet e tij, subjekti ka pretenduar se në datën 22.6.2011, është kaluar në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., shuma prej 23,000 euro dhe si burim krijimi i kësaj shume kanë shërbyer ndihmat e dhënë prej familjarëve në shumat 8,000 euro dhe 250,000 lekë, pakësimi i gjendjes *cash* të deklaruar, si dhe kursimet nga pagat tona deri në qershor të vitit 2011. Sipas akteve rezulton se në datën 2.6.2011 nuk është konsumuar e gjithë vlera *cash*, gjendje në fund

të vitit 2010. Bazuar edhe në shpjegimin e sipërcituara pas pagesës së shumës 2,500,000 lekë, vlera e gjendjes *cash* nga viti 2010 ka ngelur afërsisht në shumën 950,000 lekë (diferenca ndërmjet 3,450,000 lekë e gjendjes *cash* në vitin 2010 dhe pakësimit të saj me pagesën e kështit në shumën 2,500,000 lekë). Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se arsyeja e marrjes së ndihmës nga familjarët ka pasur si qëllim vetëm mosprishjen e kontratave të depozitave dhe humbjen e interesave që do të maturoheshin me mbarimin e afatit të kontratës së depozitës. Sa i takon personave që e kanë ndihmuar, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion dokumentacion ligjor me të cilin provohet fakti se të afërmit e tij jetojnë jashtë shtetit dhe punojnë me dokumente të rregullta<sup>8</sup>.

Ndërsa shumica ka vlerësuar marrjen në konsideratë të pretendimeve të subjektit, unë si anëtare në pakicë vlerësoj se shpjegimet e dhëna prej tij në lidhje me burimin e ligjshëm të pagesës prej 23,000 euro nuk qëndrojnë, referuar fakteve si vijojnë:

- gjendja e kursimeve *cash* në vitin 2010 është 950,000 lekë dhe jo 3,450,000 lekë sa pretendon subjekti (arsyetuar më sipër);

- edhe nëse do të merrej në konsideratë pretendimi i subjektit se gjendja *cash* për vitin 2010 është 3,450,000 lekë, nga të cilat 2,500,000 lekë janë përdorur për pagesën në datën 8.6.2011, shuma e mbetur prej 950,000 lekësh plus 8,000 euro dhe 250.000 leke, ndihma nga familjarët, plus kursimet nga pagat deri në qershor të vitit 2011 prej 650.000 lekësh, do të ishte më pak se 23.000 euro.

Sa i takon ndihmës nga familjarët për të cilët shumica ka vlerësuar të konsiderohet si burim i ligjshëm, unë vlerësoj se subjekti përveç se nuk ka vërtetuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të familjarëve, marrja e ndihmës financiare është e pa dokumentuar dhe e pa deklaruar si burim për blerjen e pasurisë objekt shqyrtimi. Pavarësisht se shumat janë marrë dhe janë kthyer brenda vitit, subjekti duhet të deklaronte ndihmën nga familjarët (e cila në fakt është një hua përderisa subjekti deklaronte se e ka kthyer) si burim për blerjen e pasurisë, gjë që nuk e ka bërë as në deklaratën periodike vjetore dhe as në deklaratën *Vetting*<sup>9</sup>.

Sa më sipër, vlerësoj se subjekti nuk ka kundërshtuar barrën e provës në lidhje me burimin e ligjshëm për pagesën e shumës 23,000 euro. Veç kësaj, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë së vitit 2011 dhe as në deklaratën *Vetting* shumën 23,000 euro, të paguar në llogari të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., si burim për blerje apartamenti, dhe as burimin e krijimit të kësaj shume, shumë e cila është depozituar *cash* në llogarinë bankare të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k.

Në përfundim, theksoj edhe një herë se, ne vijim të qëndrimit që kam mbajtur edhe me subjekte të tjerë të rivlerësimit, nuk bie dakord me qasjen e shumicës dhe qëndrimin e mbajtur në lidhje me konsiderimin e likuiditeteve në *cash*, për më tepër, në kushtet kur në disa raste subjekti ka kryer deklarime kontradiktore e janë vërejtur mosperputhje deklarimesh, të cilat e kanë bërë objektivisht të pamundur vërtetimin e pretendimeve të tij në lidhje me likuiditetet *cash*.

Sa i takon detyrimit të deklarimit të saktë të gjendjeve *cash*, shtesave ose pakësimeve të gjendjes *cash* në fund të çdo viti, përveç se është një detyrim i parashikuar nga ligji nr. 9049/2003, i ndryshuar, praktika e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, është tashmë e konsoliduar

<sup>8</sup> Konkretisht: vëllai G. D. i cili i ka dhënë shumën 4,000 euro, jeton në Itali dhe punon me dokumente të rregullta që nga viti 2002; vëllai i bashkëshortit S. Z. i cili i ka dhënë shumën 2,000 euro, jeton në Greqi dhe punon me dokumente të rregullta që nga viti 2000; motra e bashkëshortit A. Sh. e cila i ka dhënë shumën 2,000 euro së bashku me bashkëshortin e saj jeton dhe punon në Itali që nga viti 2001, ashtu sikurse si dhe motra e subjektit E. B., e cila i ka dhënë shumën 250,000 lekë.

<sup>9</sup> Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016, subjektet kanë pasur të drejtën dhe detyrimin ligjor që të plotësonin një deklaratë të detajuar të interesave private, në të cilin kanë pasur mundësinë të saktësonin çdo detaj në lidhje me burimin e krijimit të çdo lloji pasurie, duke u bazuar në dokumente shkresore.

dhe e aplikuar në disa subjekte rivlerësimi me situata të ngjashme. Konkretisht, në vendimin (JR) nr. 27, datë 22.10.2020, Kolegji arsyeton se: “ Në dritën edhe të jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit (shih vendimet nr. 6/2018, nr. 8/2018, nr. 9/2018, nr. 11/2018, nr. 12/2018, nr. 5/2019, nr. 19/2019, nr. 20/2019 etj.), në kushtet kur shpjegimet mbi gjendjen e likuiditeteve cash jashtë sistemit bankar bien ndesh me deklaratimet e vetë subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave private periodike vjetore, të cilat konsiderohen provë në procesin e rivlerësimit, në zbatim të nenit 32, pika 5, e ligjit nr. 84/2016 dhe së bashku me deklaratën ‘Vetting’ përbëjnë të vetmen mënyrë verifikimi të ekzistencës së kësaj pasurie në funksion të procesit të rivlerësimit... ndërsa deklaratimet periodike vjetore përbëjnë dokument zyrtar sipas ligjit dhe janë të vetmet referenca të ekzistencës së likuiditeteve cash jashtë sistemit bankar dhe kanë vlerë prove në procesin e rivlerësimit [në zbatim të nenit 32, pika 5, e ligjit nr. 84/2016], analiza e deklaratës ‘Vetting’ dhe e shpjegimeve të subjekteve në proces përkundër deklaratave periodike është esenciale në vlerësimin e krijimit të pasurive në analizë të mundësive të krijimit me burime të ligjshme ”<sup>10</sup>.

Për të gjitha sa kam përmendur dhe arsyetuar më sipër, gjendja cash, në fund të çdo viti, në vlerësimin tim i anëtare në pakicë, duhet marrë sikurse është deklaruar në DPV-të e viteve përkatëse nga subjekti, konkretisht si vijon:

- Në DPV-në e vitit 2003, subjekti ka deklaruar shumën 0,631,740 lekë, në rubrikën “likuiditete”, ndërsa në pyetësonin nr. 2 subjekti sqaron se: “... kjo shumë është vlera e kursimeve nga paga ime dhe nga të ardhurat e bashkëshortit tim. Duke mos e kuptuar në atë kohë që kjo vlerë duhej të paraqitej si gjendje cash, nga ana ime është pasqyruar e gjithë shuma e kursimeve në kolonën e deklaratës ku flitej për të ardhurat vjetore për pasurinë e deklaruar prej meje si depozita me afat”. Shuma prej 631,740 lekësh me të drejtë është përfshirë në analizën financiare si kursime/gjendje cash për vitin 2003 dhe sikurse ka deklaruar subjekti.
- Në DPV-në e vitit 2004, subjekti nuk ka deklaruar kursime cash, por në përgjigje të pyetësonit nr. 2, ka deklaruar se: “... një pjesë e kësaj shume, vlera prej 600,000 lekësh në datën 22.4.2004, në vitin pasardhës është depozituar në ‘Tirana Bank’ prej bashkëshortit tim”. Për këtë arsye, me të drejtë, gjendja cash në fund të vitit 2004 është konsideruar 0 (zero) lekë.
- Në DPV-të për vitet 2005, 2006 dhe 2007 subjekti nuk ka deklaruar asgjë në lidhje me gjendjen cash, kështu me të drejtë gjendja cash është konsideruar 0 (zero) lekë për këto vite, në analizën financiare.
- Në DPV-në e vitit 2008, gjendja cash është në shumën 1,500,000 lekë (trajtuar më sipër).
- Në DPV-në e vitit 2009, gjendja cash është në shumën 3,500,000 lekë (trajtuar më sipër).
- Në DPV-në e vitit 2010 gjendja cash është në shumën 950,000 lekë (trajtuar më sipër).
- Në DPV-në e vitit 2011 gjendja cash është në shumën 400,000 lekë dhe, si e tillë, është marrë me të drejtë në konsideratë.

Deklarimet e cash -it, janë përmbledhur në tabelën me poshtë:

Viti	Përshkrimi në DPV	Vlera në lekë
2003	Të ardhura të akumuluar vit pas viti	0,631 740
2004	Asnjë deklaram	0
2005	Asnjë deklaram	0
2006	Asnjë deklaram	0

<sup>10</sup> Shihni vendimet (JR) nr. 11/2019, në pikën 27.12.18 të paragrafin 27; (JR) nr. 19/2019 në paragrafin 84; (JR) nr. 20/2019 në paragrafin 59 dhe (JR) nr. 29/2019 në paragrafin 3.

2007	Asnjë deklaram	0
2008	Të ardhura <i>cash</i> (një pjesë e kontratës paraprake të shitjes e përmendur në f. 3 <sup>11</sup> të deklaratës)	1,500,000
2009	Të ardhura <i>cash</i> (një pjesë e të ardhurave të tërhequra nga depozitat bankare të deklaruara në vitin 2009 së bashku me të ardhura të deklaruara po atë vit, si dhe depozitën e tërhequr dhe deklaruar në paragrafin <sup>12</sup> më sipër).	3,500,000
2010	Të ardhura <i>cash</i> Burimi krijimit: kursime nga paga dhe të ardhurat e tjera të deklaruara.	950,000
2011	Të ardhura <i>cash</i> Burimi krijimit: kursime nga paga dhe të ardhurat e tjera të deklaruara.	400,000

Bazuar në sa më sipër, balanca negative për të gjithë periudhën e rivlerësimit, është në vlerën -2.880.726 lekë, ndërkohë që vlera e rezultuar në përfundim të hetimit administrativ ka qenë -2.349.336 lekë. Diferenca prej 531.390 lekësh ka ardhur si rezultat i trajtimit në mënyrë të ndryshme nga unë si anëtare në pakicë, të gjendjes *cash* deklaruar në deklaratën periodike për vitin 2008.

Në përfundim, sipas përcaktimeve të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, gërmat “a” dhe “b” subjekti: (i) ka kryer deklarime të pasakta dhe që vijnë në kundërshtim me ligjin; (ii) ka mungesa burimesh financiare me të ardhura të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet për shkak të një balance negative prej - 2.880.726 lekësh për të gjithë periudhën e rivlerësimit. Si anetare në pakicë, vleresoj se subjekti ka kryer deklarim të pamjaftueshëm të pasurisë sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet pikës 5, të nenit 33 të këtij ligji, dhe për këtë arsye kam votuar për shkarkimin e subjektit nga detyra.

### **Anëtare në pakicë**

#### **Firdes SHULI**

<sup>11</sup> Në f. 3 është deklaruar shitje apartamenti me sip. 85.1 m<sup>2</sup>, lagjja “\*\*\*\*”, Fier, me kontratë paraprake nr. \*\*\*, në shumën 3,100,000 lekë.

<sup>12</sup> Në DPV-në e vitit 2009, në paragrafin më sipër, është deklaruar: “Depozitë e tërhequr nga ‘Raiffeisen Bank’ në datën 26.1.2009, në shumën 660,681 lekë”.